



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



ZYRA PËR INFORMIM

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

PLANI VJETOR PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2026

Nr. Br. 030/03-4868/26
24.03.2026
Dragash - Dragaš

Plani Vjetor i Punës për Informim dhe Komunikim për vitin 2026¹ paraqet një kornizë të strukturuar të veprimeve që synojnë përmirësimin e komunikimit institucional dhe rritjen e transparencës ndaj publikut. Duke u mbështetur në parimet e qeverisjes së mirë, ky plan synon të forcojë marrëdhëniet me mediat dhe të krijojë mekanizma efikas për shpërndarjen e informacionit të saktë, të shpejtë dhe të besueshëm.

Në të njëjtën kohë, plani vendos theks të veçantë në rritjen e ndërveprimit me qytetarët, duke promovuar pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse dhe duke siguruar qasje të hapur në informacionet publike. Përmes aktiviteteve të planifikuara, synohet ndërtimi i një komunikimi të qëndrueshëm, i cili rrit besimin e qytetarëve ndaj institucionit dhe përmirëson llogaridhënien publike.


Zbatimi i këtij plani do të kontribuojë në avancimin e transparencës, në fuqizimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje, si dhe në rritjen e efikasitetit të komunikimit institucional në nivel lokal.

¹ Plani mund të pësojë ndryshime varësisht nga kërkesat që mund të vijnë nga Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Drejtoritë Komunale, Njësitë/Zyrat, si dhe kërkesat që mund të vijnë nga niveli qendror - Qeveria dhe Ministritë.

Nr	Aktiviteti	Afati	Përgjegjës
1	Raportimi vjetor te Agjencia për Informim lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike 2025	Janar 2026	Zyra për Informim
2	Trajtimi fillestar i kërkesave për qasje në dokumente publike	Gjatë vitit	Zyra për Informim
3	Publikimi në kohë reale i agjendave për aktivitete të ndryshme komunale	Gjatë vitit	Zyra për Informim
4	Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës	Gjatë vitit (në baza mujore)	Zyra për Informim
5	Publikimi i vendimeve të Kuvendit të Komunës	Gjatë vitit	Zyra për Informim
6	Publikimi i dokumenteve buxhetore	Gjatë vitit	Zyra për Informim & ZKF
7	Publikimi i lajmeve/njoftimeve, shpalljeve dhe konkurseve në uebfaqe dhe rrjetin zyrtar social Facebook	Gjatë vitit	Zyra për Informim
8	Publikimi i të gjitha dokumenteve të prokurimit në uebfaqen zyrtare	Gjatë vitit	Zyra e Prokurimit & Zyra për Informim
9	Mirëmbajtja teknike dhe përditësimi i uebfaqes	Gjatë vitit	Zyra për Informim & IT
10	Transmetimi online i mbledhjeve të Kuvendit	Gjatë vitit	IT & ZI Mediat e kontraktuara
11	Hartimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030	Shkurt-Maj 2026	Zyra për Informim & Grupi Punues
12	Takimi i Parë Publik me Qytetarë i Kryetarit të Komunës	Qershor 2026	Zyra për Informim & Kabineti i Kryetarit
13	Organizimi i dëgjimeve buxhetore për Draftin e KAB 2027-2029	Qershor 2026	Zyra për Informim & Drejtoria e Financave
14	Organizimi i dëgjimeve buxhetore për Draftin e Buxhetit 2027	Gusht 2026	Zyra për Informim & Drejtoria e Financave
15	Takimi i Dytë Publik me Qytetarë i Kryetarit të Komunës	Dhjetor	Zyra për Informim & Kabineti i Kryetarit

Zbatimi i këtij Plani vjetor kërkon angazhim të plotë nga të gjitha strukturat përgjegjëse, me ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi në realizimin e aktiviteteve të parapara. Çdo njësi dhe zyrtar i përfshirë do të jetë përgjegjës për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të obligimeve që dalin nga ky plan, duke siguruar koordinim të vazhdueshëm dhe raportim të rregullt mbi progresin. Realizimi i suksesshëm i aktiviteteve dhe zbatimi konsekuent i planit do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e komunikimit institucional, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucionit.

Fari Kolloni
Zyrtar për Informim

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Fari Kolloni', written over a horizontal line.